



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**



***Strategjia e Teknologjisë dhe Inovacionit në Mësimdhënie e Nxënie***

**Miratuar me Vendimin e Dekanatit**

**Nr. 150 datë 21.12.2021**

**Dhjetor 2021**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

## *Hyrje*

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja (FGJH) mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 6/20, Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026, ka hartuar “Strategjia e Teknologjisë dhe Inovacionit në Mësimdhënie e Nxënie”, duke paraqitur politikat për prioritetet strategjike për vitet 2021-2024.

Kjo strategji është në sinkroni të plotë me prirjet kryesore të zhvillimit të Arsimit të Lartë (AL) në Shqipëri, Evropë dhe në botë. Qëllimi i saj është të përmirësojë mësimdhënien dhe të nxënit. Në kuadrin e ndryshimeve të vazhdueshme në arsim për t’ju përgjigjur reformave të reja dhe kërkesave në rritje për mësues të aftë që të përgatisin individë me njohuri të qëndrueshme dhe aftësi praktike për të përballuar sfidat e shekullit të 21-të, është e domosdoshme që edhe stafi akademik të mbështetet me infrastrukturë dhe trajnime për të mundësuar zhvillimin e mëtejshëm profesional të tyre.

Në këtë strategji pasqyrohet vizioni i FGJH-së për politikat afatmesme dhe afatgjata në mësimdhënie, përvetësim dijesh, inovacion dhe integrimin e teknologjisë në mësimdhënie. Procesi i ndryshimit drejt cilësisë, të një sistemi kompleks si ai i mësimdhënies dhe përvetësimit të dijeve, kërkon kohë dhe mbështetje financiare nga Universiteti i Tiranës (UT) apo donatorë dhe është kjo arsyeja se pse Strategjia FGJH-së shtrihet në një periudhë tre vjeçare.

Në fokus kryesor të kësaj strategjie janë gjithëpërfshirja dhe barazia në arsim, digjitalizimi, zhvillimi profesional i profesorëve me anë të trajnimeve si brenda ashtu edhe jashtë vendit, përafërsimi i kurikulave me aftësitë që kërkon tregu i punës, ndërtimi i infrastrukturës





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

mbështetëse për një arsim të denjë për shekullin e 21-të si salla multimediale, laboratorë përkthimi, laboratorë didaktikë dhe laboratorë për mësimin e gjuhëve të huaja me anë të aplikacioneve dhe jo vetëm.

Gjithashtu ne synojmë të pajisim studentët me **kompetencat kyç për të mësuarit gjatë gjithë jetës**<sup>1</sup> si: a) kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; b) kompetenca e të menduarit; c) kompetenca e të mësuarit për të nxënë; ç) kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin; d) kompetenca personale; dh) kompetenca qytetare; e) kompetenca digjitale, që të kënë mundësi të bëjnë një lidhje organike nga bankat e FGJH-së me vendet e punës.

## **Vizioni**

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja do të vijojë të konsolidojë pozicionin e tij si institucioni kryesor me kontributin më të madh në vend në mësimin e gjuhëve të huaja, duke prodhuar specialistë dhe profesionistë, që i përgjigjen kërkesave të tregut dhe njëkohësisht ndihmojnë në zhvillimin e vendit në intergimin evropian. FGJH-ja ofron shërbime mësimi, përkthimi, trajnimi dhe ekspertizë në fushën e gjuhëve të huaja.

Përmes mësimit, shërbimit dhe kërkimit, FGJH-ja synon të kontribuojë në formimin cilësor të studentëve, në përmbushjen personale të tyre, në krijimin e mirëkuptimit të ndërsjellë, të harmonisë shoqërore dhe ndjenjës së qytetarisë globale të shekullit 21-të, të shërbejë si urë

<sup>1</sup>European Union, "Council Recommendation of 22 May 2018 on key competences for lifelong learning (2018/C 189/01)," 2018.





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

komunikimi për çështjet me interes kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, duke krijuar një hapje dhe ndjeshmëri ndaj kulturave të ndryshme në fushën e gjuhëve, letërsisë dhe komunikimit.

FGJH-ja, do të luajë një rol të rëndësishëm në realizimin e strategjisë të zhvillimit institucional të Universitetit të Tiranës, si pjesë përbërëse e tij, duke bashkëvepruar me strukturat dhe fakultetet e tjera të tij.

### **Misioni**

- T'i përgatisë studentët me kompetenca në mësimdhënie, komunikim të gjuhëve dhe kulturave të ndryshme, për t'i bërë ata anëtarë të ndjeshëm në një shoqëri globale.
- Të rrisë aftësinë komunikuese të studentëve përmes programeve sfiduese, metodologjive inovative të mësimdhënies dhe mbështetjes së procesit mësimor dhe të nxënimit me teknologjinë moderne bashkëkohore.
- Të krijojë dhe zhvillojë një mjedis akademik që nxit mirëkuptimin dhe ndërveprimin ndërkulturor në shoqëri dhe promovon shkëmbime gjuhësore, akademike dhe kulturore.
- Të nxisë bashkëpunimin akademik me institucionet homologe dhe bashkëpunimin me institucionet qeveritare, organizata profesionale dhe komunitetet lokale për ndërveprimin në shoqëri dhe promovimin e shkëmbime gjuhësore, akademike e kulturore.
- Të zhvillojë dimensionin ndërkombëtar për t'u bërë një mediator ndërmjet kulturës kombëtare dhe asaj botërore.
- Të ofrojë shërbime mësimi, përkthimi, trajnimi dhe ekspertizë në fushën e gjuhëve të huaja.





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

- Të nxisë bashkëpunimin akademik me institucionet homologe dhe bashkëpunimin me institucionet qeveritare, organizata profesionale dhe komunitetet lokale për ndërveprimin në shoqëri dhe promovimin e shkëmbimeve gjuhësore, akademike e kulturore.

Për realizimin e “Strategjisë së Teknologjisë dhe Inovacionit në Mësimdhënie e Nxënie”, FGJH-ja do fokusohet në tre vitet e ardhshme në:

- Përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënies nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm të personelit akademik;
- Përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimeve mbështetëse akademike në mënyrë që të plotësohen nevojat e FGJH-së me auditore cilësore, laboratore përkthimi e didaktike, pasurimin me libra bashkëkohorë të bibliotekave në perspektivën e arritjes të standarteve për integrimin në Bashkimin Evropian (BE) në kuptimin e treguesve për shkollimin tercial të popullsisë psh: hapësira akademike për numër studentësh, numri i studentëve në auditore, numri i pedagoqeve për studentë, bibliotekat e pasuruara, bibliotekat virtuale etj.
- FGJH-ja do të bashkëpunojë intesivisht me institucionet publike dhe private, organizata, Institute Kulturore dhe Arsimore, agjensi turistike dhe përkthimi etj me qëllim partneritetin drejt kërkimeve shkencore, praktikave mësimorë, intershipeve dhe të mësuarit më cilësor.
- Bashkëpunimin me aktorët lokalë: Prefekturën, Qarkun, Bashkinë, Zyrën e Punës, Dhomën eTregtisë dhe Industrisë, Drejtorinë Rajonale të Arsimit, shoqatat e mësuesëve, agjenistë e huaja dhe vendase etj, në realizimin e aktiviteteve të përbashkëta, studimeve dhe kërkimeve në funksion të zhvillimit të Rajonit e më gjerë.





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

Realizimi i sa më sipër do të sigurojë që Zhvillimi Strategjiki FGJH-së mbi Teknologjinë dhe Inovacionin në Mësimdhënie e Nxënie të jetë koherent, të vazhdojë të plotësojë nevojat akademike të studentëve, por në të njëjtën kohë të mbështetë stafin akademik me infrastrukturë, trajnime brenda dhe jashtë vendi.

## ***Qëllimi dhe Objektivat strategjik***

### **Qëllimi**

Të ofrojë arsimim cilësor nëpërmjet dijeve të qëndrueshme, kërkimit shkencor dhe inovacionit.

### **Objektivat**

Objektivat Strategjike të FGJH-së janë formuluar në zbatim të Vizionit e Misionit të tij dhe në përputhje me Vlerat Udhëheqëse të tij. Ato zbërthejnë Qëllimin Strategjik afatmesëm të FGJH-së si dhe iu përgjigjen çështjeve strategjike me të cilat përballet ajo.

Do të ndalemi në një nga Objektivat Strategjikë (OS) të FGJH:

- **Inovacioni dhe Teknologjia në mësimdhënie e nxënie**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

Në FGJH, nxënia mbetet funksioni qendror dhe mësimdhënia është qëllimi kryesor i institucionit. Ky qëllim do të arrihet duke vlerësuar dhe mbështetur risitë në metodat e mësimdhënies dhe duke promovuar kontributet e secilit pedagog në lidhje me to në rang fakulteti, në nivel kombëtar e ndërkombëtar. FGJH-ja do të krijojë një mjedis që promovon të mësuarin e angazhuar, aktiv dhe bashkëveprues, që ka si qëllim të tij final të përgatisë studentë elitare në profesionet e tyre të ardhshme të punës, si dhe që do të dinë si t'i trajtojnë problemet sipas qasjeve kritike dhe analizuese, gjithmonë duke i shërbyer edhe dialogut konstruktiv në nivel institucioni, kombëtar, rajonal dhe global.

Përsa i përket mësimdhënies, ka dy kategori standardesh cilësie: standarde për metodat e mësimdhënies dhe standarde për përmbajtjen e mësimin. FGJH-ja do të zhvillojë një metodologji të mirëstudiuar në mënyrë që të ketë një hov cilësor për një mësimdhënie sa më bashkëkohore. Rritja e nivelit të mësimdhënies në FGJH nuk është thjesht çështje prioritare; ajo kushtëzohet në radhë të parë prej faktit se jo të gjithë pedagogët përdorin metoda që zhvillojnë tek studentët ato shprehje dhe kompetenca, që u duhen atyre për të ardhmen kur të përballen me tregun e punës. Ndryshimi i stilit dhe metodave të mësimdhënies kërkon një investim madhor në zhvillimin e personelit akademik ekzistues me metodat bashkëkohore të mësimdhënies si metodat bashkëvepruese edhe me ndihmën e mjeteve teknologjike duke vendosur në qëndër studentin. Për të patur një mësimdhënie cilësore dhe me informacion të pasur, personeli akademik duhet të angazhohet në një punë të thelluar kërkimore dhe pedagogjike që t'i lejojë ndjekjen në vijimësi të zhvillimeve më të fundit në fushat e tyre përkatëse. Është e rëndësishme që personeli akademik të ndërgjegjësohet që mësimdhënia e shekullit të 21-të është ndryshe nga ajo që kemi ushtruar deri tani. Ndaj do të ngrihet një strukturë e cila nuk do të përditësojë vetëm metodat e mësimdhënies së mësuesëve që janë të punësuar në sektorin publik apo privat, por edhe të vetë stafit akademik të brendshëm të





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

FGJH-së me anë të trajnimeve të ofruara nga ekspertë vëndas dhe/apo të huaj.

Ky objektiv strategjik do të arrihet përmes vlerësimit dhe mbështetjes së inovacionit në mësimdhënie dhe promovimit të kontributeve të pedagogëve në dialogun akademik për mësimdhënien dhe të nxënit nëpërmjet:

- Mbështetjes së pedagogëve për të arritur potencialin e tyre të plotë përmes zhvillimit profesional të vazhdueshëm;
- Zhvillimit të metodologjive të mësimdhënies bazuar në qasjen e përzier të të mësuarit dhe përmirësimi i aftësive të tyre digjitale;
- Krijimin e një fondi për të mbështetur inovacionin që nxit mësimdhënien e efektshme;
- Zbatimin e modeleve inovative të mësimit miks, si: kombinimi i mësimit në auditor, jashtë tij dhe në platformat digjitale, përfshirja e mediave sociale, etj;
- Mësimdhënien e orientuar drejt kërkimit, e cila do të realizohet nëpërmjet të kuptuarit dhe zbatimit të metodologjive, aftësive dhe teknikave të kërkimit në disiplina mësimore;
- Mësimdhënien e bazuar në mentorimin kërkimor, e cila do të realizohet nëpërmjet mentorimit të pedagogëve për shkrimin e kumtesave për konferencën e studentëve, për punimet e diplomës; për vlerësimin e punimeve shkencore;
- Fuqizimin e mësimdhënies së bazuar në kërkim, e cila do të realizohet nëpërmjet detyrave kërkimore të shkallës së vogël në lëndë të veçanta; si ese, studim rasti, analiza;
- Përditësimi ne programeve tona, nevojat e tregut të punës në bazë departamenti dhe grupe lëndore;
- Krijimin e një njësie të specializuar, “Qendra e Trajnimeve”, me detyrë të krijojë, organizojë dhe mbështesë programe dhe iniciativa që lidhen me risi në mësimdhënie e që sjellin rezultate në nxënie. Aktiviteti i saj do të përfshijë gjithashtu një shkëmbim të praktikave më të mira të mësimdhënies akademike dhe të këshillimit akademik ndaj studentit;







**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

- Krijimin e një fondi për novacione në mësimdhënie, i cili promovon mësimdhënien aktive dhe të angazhuar;
- Ofrimin e mundësive të zhvillimit profesional për pedagogët e brendëshëm të bëhen të aksesueshme edhe për stafin me kohë të pjesshme të FGJH-së;
- Nxitjen e studentëve të antarësohen në organizata dhe shoqata profesionale brenda dhe jashtë vendit, që të kenë mundësi të përditësojnë dijet e tyre;
- Përditësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të programeve mësimore dhe programeve të lëndëve me qasje të reja metodologjike dhe teknologjike;
- Zhvillimin dhe rishikimin e programeve të lëndëve për përfshirjen në to të mënyrave më të fundit teknologjike në ndihmë të mësimdhënies, duke u bazuar dhe në ndryshimet më të fundit teknologjike dhe të infrastrukturës logjistike që ofron FGJH-ja.
- Nxitjen dhe shpërblimin e pedagogëve që marrin përsipër zhvillimin e kurseve ndërdisiplinore apo ekstrakurikulare;
- Ofrimin e programeve ndërkurrikular si dhe marrjen e një vlerësimi nga të diplomuarit (ALUMNI FGJH) në lidhje me programet mësimore dhe programet e lëndëve në të gjitha nivelet: Bachelor, Master dhe Doktoraturë;
- Organizimin e forumeve me temë përmirësimin e mësimdhënies dhe të nxënies;
- Organizimin e prezantimeve mbi mësimdhënien dhe nxënien;
- Organizimin e simpoziumeve mbi mësimdhënien dhe nxënien me profesorë të ftuar;
- Përdorimin e informacionit të agreguar nga pyetësorë të vlerësimit të pedagogëve, për të ndërtuar programe për trajnimin e zhvillimin e pedagogëve.
- Adaptimin e instrumenteve të reja për sigurimin e cilësisë;
- Zbatimin e një përqsajeje shumëdimensionale për vlerësimin e mësimdhënies;
- Përdorimin e rezultateve nga vlerësimet e studentëve për pedagogët si një bazë për përmirësimin e mësimdhënies, për të adresuar problemet në programet e studimit, dhe për trajnimin e zhvillimin e pedagogëve.





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

- Bashkëpunimin me institucione publike dhe private të arsimit të lartë për të krijuar një dialog kombëtar për mësimdhënien dhe nxënien;
- Promovimin dhe mbështetjen e përfshirjes së pedagogëve në organizata që merren me përmirësimin e mësimdhënies;
- Përfshirjen aktive si institucion dhe ekspertë në dialogun kombëtar mbi sigurimin e standardeve të cilësisë në arsimin e lartë;
- Promovimin e performancës së të diplomuarve të FGJH-it në testet standarte të njohurive (p.sh., Provimi i Liçensës për mësues të gjuhëve të huaja)
- Sigurimin dhe mirëmbajtjen e një teknologjie informacioni të përparuar në mbështetje të një mësimdhënieje sa më cilësore.
- Zhvillimin e mëtejshëm të njohurive teknologjike të personelit akademik në lidhje me pajisjet digjitale në ndihmë të mësimdhënies dhe komunikimit *on-line* me studentët, duke adresuar praktikatat më të mira në këto drejtime.

### ***E-Studenti***

Si pjesë e Universitetit të Tiranës, FGJH-ja do të integrojë sistemin E-Studenti duke i dhënë mundësi studentëve të aksesojnë notat e tyre, orarin mësimor, shërbime të ndryshme dhe në të njejtën kohë edhe stafi akademik do të pajiset me kredencialet e veta për të përditësuar këtë platformë me informacionet e nevojshme. Pajisja e FGJH-së me këtë platformë shton mundësi komunikimi student-pedagoge student-administratë, si dhe vë në dispozicion bibliotekat *on-line*.





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

Veprimet që do ndërmerren:

- Krijimi i Degës së Cilësisë, Vlerësimit dhe Kurrikulat;
- Krijimi i një njësie të specializuar, “Qendra e Trajnimeve”;
- Trajnime për përditësimin e aftësive mësimdhënëse nëpërmjet teknologjive të reja;
- Përgatitja e materialeve mësimore digjitale;
- Përdorimi i fidbekut të studentëve për mësimdhënien;
- Përdorimi i platformës elektronike për vlerësimin e studentëve;
- Dokumenti i politikave për integritetin e kërkimit të pedagogëve dhe studentëve;
- Paisja e sallave me projektorë;
- Paisja e departamenteve me më shumë kompjutera në dispozicion të stafit akademik;
- Paisja e disa sallave me tabela interaktive;
- Trajnime të stafit akademik dhe studentëve mbi teknologjitë e reja në mësimdhënie dhe nxënie;
- Trajnime të stafit akademik dhe studentëve mbi aplikacione të reja që ndihmojnë në mësimdhënie dhe nxënie;
- Trajnime të stafit akademik dhe studentëve mbi qasje dhe metodologji të reja ndihmojnë në mësimdhënie dhe nxënie;
- Trajnime për përdorimin e E-Studenti për studentët, pedagogët dhe personelin administrativ të autorizuar;
- Vënia në funksion me tipare të plota të platformës E-Studenti dhe përdorimi i tij nga studentët, pedagogët dhe personeli administrativ i autorizuar për të gjitha funksionet e parashikuara;





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

Për të qenë më konkurrues në treg, FGJH-së i duhen mjedise bashkëkohore sikundër janë laboratorët shkencorë për realizimin jo vetëm të kërkimit shkencor por edhe për procesin e mësimdhënies. Laboratorët kërkimor shkencor janë një pjesë e qenësishme e sistemit arsimor duke qenë se funksionet që ato kryejnë dhe mundësitë që ofrojnë si për stafin akademik ashtu dhe studentët janë më të shumëllojshme sesa ato të përdorura në klasat tradicionale. Ato shërbejnë si mjedise ku jo vetëm mësohet dhe praktikohet gjuha e huaj por dhe realizohet punë kërkimore dhe në veçanti eksperimente apo vëzhgime për qasjet e reja gjuhësore, për njohje me teknologji të reja në mësimdhënie, shkrime artikujsh apo teza doktoratash.

Laboratorët kërkimor shkencorë bëjnë të mundur kryerjen e hulumtimeve në mënyrë më efektive dhe ofrojnë mundësi të reja për të zhvilluar qasje të reja metodologjike, mundësi bashkëpunimi dhe zhvillimi në disiplinat ekzistuese dhe ato të reja. Për më tepër, ato ofrojnë mundësi për përçarjen e të dhënave dhe rezultateve kërkimore duke përdorur mënyra të reja. Këto mjedise do të mund të shërbejnë si një mjet për të bërë ndryshime thelbësore në procesin, përmbajtjen dhe format e mësimdhënies duke bërë që të arrihen më mirë dhe më me efikasitet qëllimet e arsimit dhe kërkimit: cilësi, integritet dhe arsimim për të gjithë.

Në kuadër të ndryshimeve thelbësore pas situatës së pandemisë, është e nevojshme që risitë të shpërfaqen në tërësinë e tyre në sistemin arsimor universitar. Krijimi i një laborator kërkimor, novator dhe gjuhësor do t'i shërbejë stafit akademik të FGJH-së si dhe studentëve të të tre cikleve të studimit. Ky laborator do të funksionojë si një qendër kërkimore, sallë mësimore por dhe sallë realizimi konferencash apo takimesh shkencore të kërkuesve në FGJH-së dhe jo vetëm. Është e rëndësishme që studentët dhe kërkuesit e rinj të gjejnë infrastrukturën e nevojshme në mënyrë që të realizojnë jo vetëm procesin mësimor por edhe punën kërkimore.





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

Laboratori do të ketë pajisje të reja si projektorë, tabela interaktive, kompjutera, kamera, internet me shpejtësi të lartë, mure ndarës që mund të hapen për të kombinuar dhomat në hapësirë më të madhe dhe mobilje të reja.

Ky laborator do të mirëmbahet nga zyra e IT-së Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në bashkëpunim me IT-në e Rektoratit. Laboratori do të vihet në shërbim të studentëve të të tre cikleve të studimit si dhe stafit akademik dhe kërkimor, por jo vetëm. Digjitalizimi i hapësirave universitare do të bëjë të mundur përçimin e njohurive dhe teknologjive më të fundit. Sigurimi i infrastrukturës së duhur kërkimore dhe mësimore për studentët dhe kërkuesit në arsimin e lartë, do të lehtësojë përballjen e tyre me sfidat dhe problematikat e hasura gjatë pandemisë dhe do t'i përgatisë ata për të qënë më afër metodave dhe qasjeve të përdorura nga kolegët e tyre evropian.

**Miratoi**

**Dekani**

**Prof. Dr. Esmeralda Kromidha**

